



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Numri i Çështjes	71026-01962-11-2025	Data e Regjistrimit	23/06/2025
Numri i Vendimit	11-2025-4571	Data e Vendimit	25/07/2025

VENDIM NE EMER TE REPUBLIKËS

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës E PERBERE NGA:

KRYESUES: Xhevdet Lika

ANËTAR

SEKRETARE Sara Bllaca

Objekti: Lirim me kusht

Baza Ligjore : Nenet 470,471/,480/1 K.Pr.Penale

Përmbledhja e vendimit:

Në përfundim të gjykimit, Gjykata pasidëgjoi palët në fazën e diskutimeve përfundimtare, ku:

- Mbrojtësi i të dënuarit ***** , av.Anita Mici, kërkojpranimin e kërkesës dhe lirimin me kusht të kërkuarit ***** për pjesën e mbetur të dënimit të caktuar ndaj tij me vendimin 21, datë 25.03.2024,të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndryshuar me vendimin nr.43, datë 08.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- I dënuari ***** u gjykua në mungesë.

- Prokuroriapranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrëskërkoj pranimin e kërkesës së kërkuarit ***** si të bazuar në ligj dhe prova.

- Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve PenaleDurrës (në vijim "IEVPDurrës") kërkoj pranimin e kërkesës së kërkuarit ***** si të bazuar nëligj dhe prova.

Vëren:

I. RRETHANAT E FAKTIT

I dënuari ***** i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me kërkesë me objekt: Lirimi parakohë me kusht për pjesën e mbetur të dënimit të caktuar ndaj tij me vendimin nr.61,datë 05.10.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndryshuar me vendimin nr.43, datë 08.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në çështjen objekt gjykimi, Gjykata vendosi të caktojseancën gjyqësore duke urdhëruar njoftimin e të dënuarit ***** dhe tëpalëve të interesuar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë tëJuridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe IEVP Durrës për ditën, orën dhe vendine gjykimit.

Gjykata e Posaçme eShkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë, me vendiminnr. 61, datë 05.10.2023, ka vendosur: 1. *Deklarimin e pafajshëm tëtë pandehurit ***** për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal, përshkak se, në bazë të nenit 388/1/b të Kodit të Procedurës Penale, fakti nukpërbën vepër penale.* 2. *Deklarimin fajtor të të pandehurit ***** për kryerjene veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i tëzgjedhurve vendorë”, të parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, dhe dënimin etij me 6 (gjashtë) vjet burgim.* 3. *Deklarimin fajtor të të pandehurit ***** për kryerjene veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisëkriminale”, e kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 287/2 i KoditPenal, dhe dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.* 4. *Në bazë të nenit 55 tëKodit Penal, në bashkim të dënimeve, i pandehuri ***** dënohet me 8(tetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.* 5. *Në zbatim të nenit 406 tëKodit të Procedurës Penale, i pandehuri ***** përfiton uljen me 1/3 tëdënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 5 (pesë) vjet e 8 (tetë) muajburgim. Vuajtja e dënimit fillon nga momenti i arrestimit, datë 14.12.2021, dhedo të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.* 6. *Nëbazë të nenit 35/1 të Kodit Penal, të pandehurit ***** i hiqet e drejtapër të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh....*

Kundër vendimit gjyqësor të sipërpërmendur është bërë ankim nga prokurori dhe nga i pandehuri ***** në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë.

Gjykata e Posaçme eApelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë, me vendimin nr. 43(87-2024-321), datë 08.11.2024, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 61, datë 05.10.2023, tëGjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me këtë ndryshim:* 1. *Deklarimin fajtor të të pandehurit ***** përkryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, e kryer në bashkëpunim, tëparashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 4 (katër)vjet burgim.* 2. *Në bazë të nenit 55/1 të Kodit Penal, në bashkim tëdënimeve, i pandehuri ***** dënohet me një dënim të vetëm prej 10(dhjetë) vjetësh burgim.* 3. *Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, ipandehuri ***** përfiton*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

uljen me 1/3 të dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.

Nga dinamika e vuajtjes së dënimit Nr.3498 prot., datë 14.07.2025, të hartuar nga IEVP Durrës, rezulton se, i dënuari ***** ka vuajtur 5 (pesë) vite e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim. Të dënuariti ka mbetur për të vuajtur edhe 1 (një) vit e 7 (shtatë) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim. I dënuari është duke vuajtur dënimin në burg të sigurisë së zakonshme. Nga dënimi i dhënë, i dënuari ***** nuk ka fituar uljedënimin me amnisti dhe me falje.

Përsa më sipër, i dënuari ***** , duke pretenduar se plotëson kushtet e nenit 64 të K.Penal, i është drejtuar Gjykatës me kërkesën penale objekt gjykimi.

II. VLERËSIMI I GJYKATËS

Gjykata vlerëson se, kërkesa e të dënuarit ***** lirim me kusht për pjesën e mbetur të dënimit të caktuar ndaj tij me vendimin me vendimin nr.61, datë 05.10.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është bazuar në ligj dhe prova, dhe si e tillë duhet pranuar.

Neni 64 i K.Penal parashikon se:

I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimi për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;

- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;

- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni.

Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.

Nuk lejohet liri me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.

Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

penale me dashje, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.

Gjykata e urdhëron të dënuarin tëmbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. Kur i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës ose kur nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi, të urdhëruara nga gjykata, kjo e fundit vendos zëvendësimin e dënimit tëparë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit tëmbikëqyrjes gjatë periudhës së provës ose revokimin e vendimin për lirin parakohe me kusht.

Lirimi me kusht është një institut i tëdrejtës penale sipas të cilit të dënuarit mund të lirohen përpara vuajtjes sëplotë të dënimit të caktuar ndaj tyre me vendim të formës së prerë. Instituti i lirit me kusht klasifikohet në K.Penal si një nga alternativat e dënimit me burgim dhe ka karakter riedukues, human dhe social.

E drejta për lirin me kusht konsiderohet pjesë e së drejtës për një trajtim human dhe dinjitoz gjatë vuajtjes së dënimit, sipas Nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (mos-ndërhyrja në trajtim mizor, çnjerëzor ose poshtërues).

Lirimi me kusht është parë si një institucion që shërben qëllimit social të rikthimit të të dënuarit në shoqëri, duke u bazuar në parimin e funksionit edukativ të dënimit dhe vlerësimin e mundësisë reale për riintegrimin në shoqëri.

Lidhur me lirin me kusht, GJEDNJ-ja është shprehur se, liri me kusht duhet të synojë ndihmën e të dënuarit për të bërë një kalim nga jeta në burg në një jetë që i përmbahet ligjit në komunitet përmes kushteve pas lirit dhe mbikëqyrjes që nxisin këtë qëllim dhe kontribuojnë në sigurinë publike dhe uljen e krimit në komunitet. Lirimi me kusht ndikon për të zvogëluar efektet e dëmshme të burgimit dhe për të nxitur riintegrimin e të dënuarve në kushte që synojnë të garantojnë sigurinë e komunitetit të jashtëm, ligji duhet ta bëjë lirin me kusht të disponueshëm për të gjithë të burgosurit e dënuar.

Kur fillojnë të vuajnë dënimin e tyre, të dënuarit duhet të dinë ose kur bëhen të ligjshëm për lirin në bazë të vuajtjes së një periudhe minimale (të përcaktuar në terma absolutë dhe/ose duke iu referuar një pjese të dënimit) dhe kriteret që do të zbatohen për të përcaktuar nëse do t'u jepet liri me kusht (*sistemi i lirit diskrecionar*) ose kur ata fitojnë të drejtë për lirin me kusht si të drejtë në bazë të vuajtjes së një periudhe të caktuar të përcaktuar në terma absolutë dhe/ose duke iu referuar një pjese të dënimit (*sistemi i lirit të detyrueshëm*). Periudha minimale ose e fiksuar nuk duhet të jetë aq e gjatë sa të mos mund të arrihet qëllimi i lirit me kusht. Kriteret që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

të burgosurit duhet të përmbushin për t'u liruar me kusht duhet të jenë të qartadhe eksplicite. Ato duhet të jenë realiste në kuptimin që duhet të marrin parasysh personalitetet dhe rrethanat sociale dhe ekonomike të të dënuarve.[1]

Ndërkohë që dënimi penal në vetvete, përmbanelemente të teorive ndëshkuese dhe parandaluese të krimit, orientimi i tanishëm në shumë legjislacione penale evropiane, sidomos në lidhje me periudhën e fundit të vuajtjes së dënimit, fokusohet në riedukimin (ose risocializimin) etë dënuarit. Karakteri “human” i lirimit me kusht lidhet me shprehjen e ndëshkimit të panevojshëm dhe është pasqyrim i drejtpërdrejtë i një prej parimeve të K.Penal, parashikuar shprehimisht në nenin 1/c të tij. Siç u përmend pak më lart, edhe vetë elementindëshkues në teorinë e së drejtës penale nuk duhet të konsiderohet si një “hakmarrje” e shoqërisë kundrejt autorit të veprës penale, por më tepër si një shprehje e shpagimit të kësaj të fundit në lidhje me sjellje të patolerueshme për një shoqëri civile dhe demokratike. Në kushtet e arritjes së qëllimit kryesor të dënimit penal, pra riedukimit të të dënuarit, si dhe plotësimit të kushteve objektive të parashikuara nga neni 64 i K.Penal, vazhdimi i vuajtjes së mëtejshme të dënimit do të konsiderohej si i panevojshëm dhe i padobishëm për shoqërinë. Efektet “sociale” të lirimit me kusht, që kanë të bëjnë jo vetëm me qëllimin e përgjithshëm të lirimit me kusht, duke shërbyer sishembull për të dënuarit e tjerë që me punë dhe sjellje të mirë mund të lirohen me kusht, por edhe me fenomenin e mbipopullimit të burgjeve, duke ulur sadopak edhe barrën financiare të taksapaguesve për sistemin penitenciar, natyrisht duke mos u sakrifikuar objektivi kryesor që është siguria e komunitetit ndaj personave me rrezikshmëri të lartë shoqërore, si dhe detyrat e legjislacionit penal dhe parimet e K.Penal, parashikuar nga nenet 1/b dhe 1/c të K.Penal.[2]

Lirimi me kusht sipas nenit 64 të K.Penal kërkon plotësimin në mënyrë kumulative të disa kushteve; **së pari**, ekzistenca e arsyeve të veçanta, të cilat vërtetojnë që i dënuari me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin e tij. “Arsyete veçanta” nuk duhen nënkuptuar si një kusht shtesë, por si një kusht i vetëm, i përbërë nga fakte të cilat provojnë se është arritur qëllimi i dënimit penal në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai/ajo është i/e gatshëm të riintegrohet në shoqëri; **së dyti**, të ketë vuajtur jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale, jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimigjer në pesë vjet burgim dhe jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, pa llogaritur kohën e përfituar nga i dënuari me amnisti ose falje; **së treti**, i dënuari të mos jetë përsëritës për krime të kryera me dashje; **dhesë katërti**, i dënuari të mos jetë dënuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

100.

Dukej'u rikthyer rastit objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se, kërkesa e kërkuarit ***** për lirimin parakohe me kusht për pjesën e mbetur të dënimit të caktuar ndaj tij me vendimin nr.61, datë 05.10.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndryshuar me vendimin nr.43, datë 08.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është e bazuar në ligj dhe prova.

Së pari: Nërastin në gjykim plotësohet kriteri që i dënuari duhet të ketë vuajtur më shumë se $\frac{3}{4}$ e dënimit të dhënë për krime mbi 5 (pesë) vite burgim. Me vendimin nr.61, datë 05.10.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndryshuar me vendimin nr.43, datë 08.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i dënuari ***** është deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale të parashikuar nga nenet 248, 260 dhe 287/2 të K.Penal dhe është dënuar përfundimisht me 6 (gjashtë) vite e 8 (tetë) muaj burgim.

Nga dinamika e vuajtjes së dënimit të hartuar nga IEVP Durrës, hartuar me datë 14.07.2025, rezulton se, kërkuari ***** ka vuajtur 5 (pesë) vite e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim. Të dënuarit i ka mbetur për të vuajtur edhe 1 (një) vit e 7 (shtatë) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim. Nga dënimi i dhënë, i dënuari ***** nuk ka fituar ulje dënimi me amnisti dhe me falje.

Deri në datën e shpalljes së vendimit, i dënuari ka vuajtur **5 (pesë) vite e 26 (njëzet e gjashtë) ditë burgim.**

Të dënuarit i ka mbetur për të vuajtur edhe 1 (një) vit e 7 (shtatë) muaj e 4 (katër) ditë burgim. Pra, i dënuari ***** ka vuajtur më shumë se $\frac{3}{4}$ e dënimit të caktuar ndaj tij.

Së dyti: I dënuari ***** rezulton se nuk përsëritës përkrime të kryera me dashje. Nga vertetimi i gjendjes gjyqësore nr.15, datë 19.06.2024, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se, i dënuari ***** nuk ka dënim tjetër përveç dënimit të caktuar ndaj tij me vendimin nr.61, datë 05.10.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndryshuar me vendimin nr.43, datë 08.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky fakt konfirmon se kemi të bëjmë me një person pa precedentë penale të mëparshëm, përveç vendimit aktual i cili është në ekzekutim. Ky fajt paraqet rëndësi sepse i dënuari nuk është përsëritës (recivist) dhe rrit besueshmërinë të rehabilitimi të tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Fakti që i dënuari nuk është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë tregon që vepra penale për të cilën është dënuar ka qenë një devijim i veçantë, i lidhur me rrethanat e caktuara dhe jopjesë e një modeli kriminal të qëndrueshëm. Një person pa dënime të mëparshme perceptohet si më pak i rrezikshëm për shoqërinë, sepse nuk ka treguar sjelljet e përsëritura antisociale. Kjo mbështet bindjen se i dënuari ka potencial real për t'u rehabilituar dhe për t'u integruar në mënyrë të qëndrueshme në shoqëri, pa rrezikuar përsëritjen e veprës.

Së treti: Referuar vendimin nr.61, datë 05.10.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndryshuar me vendimin nr.42, datë 08.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, rezulton se, i dënuari ***** nuk është dënuar për veprat penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apoparagrafi i tretë i nenit 100 të K.Penal.

I dënuari ***** është deklaruar fajtor dhe është dënuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 248, 260 dhe 287/2 të K.Penal, vera penale të cilanuk përjashtohen nga e drejta për të përfituar lirimin me kusht.

Së katëri: Gjatë gjykimit rezultojë e rrvuar se, i dënuari ***** me sjelljen dhe punën e tij ka treguar se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe reabilitimin e tij.

Referuar Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë [3] "*arsyet e veçanta*", si një ndërkushtet për lirimin me kusht, nuk duhen nënkuptuar si një kusht shtesë, por një kusht i vetëm, i përbërë nga fakte të cilat provojnë se është arritur qëllimi i dënimit penal në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai/a është i/e gatshëm të riintegrohet në shoqëri.

Në arritjen e përfundimit se, me dënimin e vuajtur, është arritur qëllimi i edukimit dhe reabilitimit të të dënuarit ***** , gjykata mbannë konsideratë sa vijon:

- Natyrën e veprave penale të kryera nga i dënuari;
- Qëndrimin e dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës;
- Gjendjen fizike dhe psikologjike të personit të dënuar;
- Dinamikën e sjelljes së të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit në IEVP;
- Raportin e Shërbimit të Provës;
- Kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

- Si dhe planet konkrete tëtij për të mundësuar riintegrimin e plotë në shoqëri pas lirimit.

a. Natyra e veprave penale të kryeranga i dënuari. Përsa ipërket kësaj rrethane, Gjykata vlerëson se, samë e lartë të jetë rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të kryer, aq më ithelluar duhet të jetë hetimi gjyqësor në lidhje me riedukimin e të dënuarit. Gjithashtu, edhe rrethanat e kryerjes së veprës penale duhen marrë në konsideratë gjatë shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht.

I dënuari***** është deklaruar fajtor dhe është dënuar përfundimisht me 6 (gjashtë) vite e 8 (tetë) muaj burgim për kryerjen e veprave penale *“Shpërdorimi i detyrës”, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, të parashikura nga nenet 248-25,260 dhe 287/2 të K.Penal.*

Duke iu referuar natyrës së veprave penale për të cilat është dënuar kërkuesi, si dhe masës së dënimit të dhënë, Gjykata çmon se veprat penale në fjalë paraqesin rrezikshmëri shoqërore të nivelit mesatar. Rrezikshmëriat nuk e përjashton mundësinë e aplikimit të lirimit me kusht, por imponon detyrimin e gjykatës për të vlerësuar me kujdes rrugën e riedukimit dhe sjelljen konkrete të të dënuarit.

Qëndrimi i të dënuarit ndaj veprës, gjendja aktuale shëndetësore, mosha, dhe rreziku i ulët për përsëritje, janë të gjitha elementë që peshojnë në favor të lirimit të parakohshëm me kusht për të dënuarin *****.

b. Qëndrimi i të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës. Pendimi i t? dënuarit duhet t? rezultojë nga t? dhëna objektive. N? k?t? kuptim, nuk mjafton vetëm deklarimi i t? dënuarit para gjykatës se shpreh pendesë për veprën e kryer, por ky qëndrim pendues t? ketë rezultuar edhe gjatë vuajtjes së dënimit, n? raport me bashk?vuajt?sit e tjerë, personelin e institutit penitenciar, me familjarët e tij, marrjen pjesë në aktivitete riedukuese, dëshirën për t? punuar, etj. Përsa i përket normalizimit t? marrëdhënieve me viktimën/t? dëmtuarin apo familjarët e tij, nëse rezulton t? ketë ndodhur, gjykata duhet natyrisht të marrë parasysh si element n? favor t? kërkuesit. Megjithatë, Kolegjet vlerësojnë se, ndërsa n? vetë normalizimi i marrëdhënieve nuk ?sht? kusht idomosdoshëm për pranimin e kërkesës për lirim me kusht, me rendësi ?sht? t? paktën tentativa e t? dënuarit për t? kërkuar faljen dhe normalizimin e marrëdhënieve me personin e dëmtuar/viktimën dhe familjen e tij, si dhe zëvendësimi i dëmit t? shkaktuar nga vepra penale ose ndihma aktive për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Nga dinamika evuajtjes së dënimit, rezulton se i dënuari ***** nuk e pranon kryerjen e veprave penale për të cilat është dënuar. Megjithatë, ai nuk ka shfaqur qëndrime të papërshtatshme dhe nuk ka manifestuar mbështetje për mendime apo qëndrime me përmbajtje kriminale.

Pranimi i fajësisë nuk është kusht idomosdoshëm për lirimin me kusht. Në shumë raste, individët që nuk e pranojnë fajësinë nuk e bëjnë këtë për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit moral, por për bindje personale për pafajësi, sidomos në raste kur vendimi penal është marrë mbi bazën e rrethanave komplekse sikurse është rasti konkret.

Mospranimi i veprës penale nga ana e të dënuarit nuk përjashton mundësinë e rehabilitimit, nëse sjellja e tij gjatë vuajtjes së dënimit është në përputhje me normat e institucionit dhe ai nuk shfaq rrezikshmëri sociale.

Pavarësisht mospranimit të fajit, i dënuarinuk shfaq qëndrime të papërshtatshme, nuk identifikohet me veprimtarikriminale, dhe nuk mbështet qëndrime me përmbajtje kriminale. Kjo është një rrethanëpozitive, që tregon se i dënuari nuk paraqet rrezik të shtuar për përsëritje të veprës penale dhe nuk ka qëndrime të dëmshme për rendin shoqëror apo moralin publik.

Nëse sjellja e të dënuarit është e qetë, edisiplinuar dhe në përputhje me rregulloren e institucionit, kjo është njëprovë konkrete e rehabilitimit të pjesshëm apo të plotë, pavarësishtmospranimit të veprës penale.

Mospranimi i fajit nga ana e të dënuarit***** nuk duhet të konsiderohet në mënyrë automatike si tregues imungesës së pendesës apo mungesës së rehabilitimit. E rëndësishme është që idënuari nuk shfaq sjellje kriminalizuese, respekton autoritetin ligjor dhe nukpërbën rrezikshmëri për shoqërinë. Në këtë kuptim, qëndrimi i tij nuk përbënpengesë për lirimin me kusht, sidomos nëse ai plotëson edhe kriteret e tjera tëpërcaktuara nga ligji, si pjesa e vuajtur e dënimit, sjellja në institucion,garancia për punësim dhe mbështetja familjare.

c. Gjendjenfizike dhe psikologjike të personit të dënuar. Nëse i dënuari ka një gjendjet? rënduar fizike apo moshë t? madhe, kjo rrethanë do t? konsiderohet n? favort? t? dënuarit, jo vetëm për arsye humanitare, por edhe pasi rrezikshmëriashoqërore n? k?t? rast do t? cilësohet si m? e ulët. Ndërkohë, n? qoftë se idënuari gëzon gjendje t? mir? fizike, kjo rrethanë do t? konsiderohet sineutrale nga ana e gjykatës, por jo n? disfavor t? kërkuesit.

Në rastin konkret, rezulton se i dënuari ***** është 61 (gjashtëdhjetë e një) vjeç, një moshë që vetë praktikagjyqësore e ka konsideruar si rrethanë që ndikon në uljen e rrezikshmërisëshoqërore, për më tepër kur shoqërohet me probleme serioze shëndetësore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Nga shkresa nr.3115 prot., datë 19.06.2025, "*Informacion mbi gjendjen shëndetësore të shtetasit ******", lëshuar nga IEVP Durrës, rezulton se, duke marrëparasysh historikun e gjatë mjekësor, gjendjen aktuale klinike, diagnozat eshuma të renda dhe të kombinuara, si dhe ecurine e parametrave jetike, gjendjashëndetësore e shtetasit ***** është veçanërisht e rëndë dhe me rrezikshmëri të lartë për jetën. Rreziku shtohet referuar edhe historikut familjar pozitiv për SAK (Sëmundje të Arterieve Koronare), pasi i vëllai i pacientit ka pasur të implementuar stentë dhe, pas disavitesh, ka humbur jetën si pasojë e komplikacioneve kardiake. Qëndrimi në kushte izolimi, pranë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, përbënjë faktor rëndësues për gjendjen shëndetësore të pacientit, i cili ka nevojë për ndjekje të specializuar kardiologjike, monitorim të vazhdueshëm dhe akses të menjëhershëm në ndërhyrje invazive, diagnostike dhe terapeutike. Këto shërbimenuk mund të garantohen në mënyrë optimale pranë IEVP-së, ku ndodhet aktualisht dënuari.

Gjithashtu, nga shkresa "*Mendim mjekësor mbi gjendjen shëndetësore ******", dt.07.02.2023, të hartuar nga Dr.Renato Osmanaj (konsulent pranë IML), rezulton se, si rezultati i gejdjes të rënduar shëndetësore dhe psikologjike pacienit (të dënuarit *****), i nevojitet kujdes i shtuadhe për kujdesje nga njerzit e afërët. Vizitat dhe konsultat e vonuara në kohë, në kushtet e burgut, si dhe gjendja e tij me kriza të vazhdueshme në kushtet e murgut, kanë bërë që pacienti të përkeqësohet dita-ditës. Pacienti kanevojë për kujdesje të shtuar, e cila gjatë gjithë kësaj periudhe i kamunguar në kohën dhe momentin e duhur. Prania e familjarëve në përditshmërinë e tij do të ndikonte në përmirësimin e gjendjes shëndetësore - jo vetëm në aspektin e depresionit dhe shëndetit mendor, por edhe në përbalimin e shqetësimeve kardiake të shtuara kohët e fundit. Këto kërkojnë një ambient samë të qetë dhe familjar, jashtë ambienteve të mbyllura si burgu, apo jashtë një hospitalizimi të vazhdueshëm në struktura spitalore, të cilat e mbajnë pacientin në një gjendje të vazhdueshme stresi, duke mos sjellë ndonjë ecuri pozitive për sëmundjen e tij, veçanërisht të natyrës kardiologjike dhe psikologjike, e cila është thellësisht e rëndë.

Lidhur me gjendjen shëndetësore të të dënuarit janë kryer 2 (dy) akte ekspertimi mjeko-ligjor, nga ekspert të IML Tiranë. Konkretisht, janë kryer aktet ekspertimit nr.2555, datë 07.11.2022 dhe nr.344/E, datë 24.07.2025, përfundime të cilëve vijojnë në harmoni me njëri-tjetrën, si dhe me dokumentacionin shëndetësor të depozituar në gjykatë nga kërkuesi (i dënuari) ***** dhe që tregojnë që gjendja shëndetësore e tij është shumë e rëndë.

Nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor Nr.2555, kryer nga IML Tiranë dhe konkretisht nga grupi i ekspertëve i përbërë nga Dr.Illir Deçolli, Dr.Elton Serani dhe Dr.Blerim Peli, rezulton se, i dënuari ***** është diagnostikuar dhe vuan nga sëmundja "Angina Pectoris e Paqëndrueshme". Nëpërmjet këtij akti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

ekspertimi, ekspertët kanë konkluduar se:

1. *Referuadokumentacionit që ndodhet në dosjen gjyqësore dhe kartelave klinike mjekësore,rezulton se shtetasi ***** vuan nga: Angina Pectoris e Paqëndrueshme; Sëmundjee arterieve koronare me ngushtim 50% të lumenit arterial; Sëmundje ishemike ezemrës; Aterosklerozë e përgjithësuar; Hipertension arterial, stadi i II-të; Blloki degës së djathtë, inkomplet (çrregullim i përcjelljes së impulseve elektriketë zemrës); Gjendje anksioze.*
2. *Referuarshqyrtimit të dokumentacionit mjekësor (kartelat klinike), ekzaminimit objektivdhe konsultave specialistike, rezulton se gjendja aktuale shëndetësore e tëhetuarit ***** është veçanërisht e rëndë.*
3. *Sëmundjet ngatë cilat vuan shtetasi ***** nuk mund të kurohen në kushtet eparaburgimit, në ambientet e IEVP-së ku ai ndodhet.*
4. ***Qëndrimi nëizolim, në kushtet e paraburgimit, referuar diagnozës së të hetuarit ***** , përbën rrezik serioz për shëndetin e tij.***

Nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr.344/E, kryer gjatë zhvillimit tëgjykimt nga ekperti Dr.Anton Samarxhiu, ka rezultuar se:

1. *Referuadokumentacionit që ndodhet në dosjen gjyqësore, kartelës klinike mjekësore dheekzaminimit objektiv, shtetasi ***** vuan nga: sëmundjae arterieve koronare të zemrës me ngushtim 50% të lumenit arterial; anginëpectoris e paqëndrueshme; arterosklerozë e përgjithësuar; hipertension arterialstadi II; kardiopati hipertensive; dislipidemi; gjendje ankthi; bllok i degës së djathtë inkomplet (çrregullim i përcjelljes së impulseve elektrike tëzemrës); dhe këputje e meniskut.*
2. *Referuarshqyrtimit të dokumentacionit mjekësor, ekzaminimit objektiv dhe konsultave tëspecialistëve, këto sëmundje janë diagnostikuar që në momentin e ndalimit dhekanë ardhur duke u përkeqësuar, duke u paraqitur si të paqëndrueshme.*
3. *Bazuarnë shqyrtimin e dokumentacionit mjekësor, ekzaminimit objektiv dhe konsultavetë specialistëve, rëndësia dhe paqëndrueshmëria e këtyre sëmundjeve paraqet njërrezik serioz për shëndetin e të dënuarit.*
4. ***Referuar protokolleveshëndetësore të IEVP Durrës dhe të Spitalit të Drejtorisë së Përgjithshme tëBurgjeve, si dhe duke u mbështetur në gjendjen aktuale shëndetësore të rëndëdhe të paqëndrueshme, nuk mund të ofrohet shërbimi i nevojshëm dhe idomosdoshëm mjekësor për diagnozat kardiake të shtetasit ***** në këtoinstitucione.***

“Angina Pectoris e Paqëndrueshme” është njëgjendje e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

paparashikueshme dhe nuk lidhet me ndonjë shkak të dukshëm, por nga ana fizio-patologjike buron nga disa procese komplekse, si: çarja e pllakësaterosklerotike, aktivizimi i trombociteve, formimi i trombit, prishja etonusit arterial dhe koronarit, mbyllja e pjesshme apo e plotë e arterieskoronare, hipertensioni arterial, etj. Angina e paqëndrueshme është njëmoment shumë i rëndësishëm i sëmundjes së arterieve koronare, pasi ka tendencë të çojë pacientin drejt infarktit akut të miokardit apo edhe vdekjes, dhe përkëtë arsye përbën emergjencë mjekësore.

Kjo formë e anginës konsiderohet si e tillë në dy situata: 1. Ndryshe nga angina e qëndrueshme, simptomat ndodhin në mënyrë të rastësishme dhe të paparashikueshme, pa ndonjë shkak të dukshëm. Angina e paqëndrueshme ndodh shpesh edhe gjatë pushimit apo në gjumë. 2. Më e rëndësishmja, në të gjitha format e Sindromës Koronare Akute (ACS), angina e paqëndrueshme është më e shpeshta, e shkaktuar nga shkëputja e një pllake në arterien koronare, që çon në bllokim të pjesshëm ose të plotë të saj. Rrezikupër një infarkt të plotë të miokardit është shumë i lartë në këtë gjendje.

Komplikacioni kryesor i anginës së paqëndrueshme është pikërisht infarkti akut i miokardit.

Referuar dokumentacionit të lartpërmendurkonstatohet se IEVP Durrës nuk disponon staf mjekësor të specializuar në kardiologji, as staf të përgjithshëm mjekësor me kohë të plotë në institucion; Nuk ka autoambulancë për raste emergjente dhe protokollet e transportit drejt spitalëve zgjasin deri në 50 minuta, duke krijuar një vonësë të papranueshme për emergjencat kardiake; Institucioni nuk ka pajisje mjekësore për trajtimkardiologjik, as kushte infrastrukturore të përshtatshme për një të paraburgosur me patologji të tilla; Procedurat spitalore për të paraburgosurit janë të vështirësuar dhe shumë të kufizuara në krahasim me pacientët civilë, duke vështirësuar ndjeshëm aksesin në mjekim dhe ndjekjen e vizitave tëspecializuara.

Në të gjithë historikun e sëmundjes, të dokumentuar nga institucionet shtetërore (IEVP 313, IEVP Fier, IML, Spitali Rajonal Durrës) dhe ato private, si dhe bazuar në vlerësimet mjekësore të deritanishme, konstatohet se mbajtja në kushtet e izolimit përbën rrezik real për jetën e shtetasit *****.

Gjendje psikologjike e rënduar dhe depressive, që përkeqësohet në mënyrë progresive.

Këto patologji janë kronike dhe progresive, e përkeqësohen me kalimin e kohës si pasojë e traumave psikike, stresit, ankthit të vazhdueshëm dhe izolimit në ambiente të mbyllura për një kohë të gjatë.

Një rol kyç në përkeqësimin e sëmundjes kardiake e luan pikërisht



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

izolimi në paraburgim, ku mungojnë kushtet enevojshme mjekësore, dhe i cili nuk mund të ofrojë trajtimin e domosdoshëm përnjë pacient me gjendje shëndetësore kaq të rënduar.

Ky pacient (i dënuari) kërkon monitorim të vazhdueshëm nga mjekë të specializuar kardiologë dhe vendosje në kushte të tilla që të shmangin trauma, stres apo ankth të vazhdueshëm, të cilat, siç rezultojnë nga dokumentacioni ekzistues, ai i ka përjetuar deri në ditën e sotme gjatë qëndrimit në izolim. Këta faktorë patologjikë, të kombinuar me mungesën e kushteve ambientale mjekësore dhe gjendjen e izolimit në paraburgim, krijojnë një rrezik të lartë dhe të vazhdueshëm për fatalitet.

Jetesa në këto kushte e ekspozon shtetasin***** ndaj rrezikut real për jetën, në çdo moment, dhe gjendja e tij vijon të përkeqësohet.

Në moshën 61 vjeç, i dënuari ndodhet në një fazë të jetës ku formimi personal dhe bindjet jetësore janë të konsoliduara, çka do të thotë se rreziku i përsëritjes së veprës penale është i ulët, ka më shumë potencial për reflektim dhe qëndrueshmëri emocionale, si dhe nuk përbën rrezik shoqëror, pasi dinamika e moshës nuk e favorizon më përfshirjen në veprimtari kriminale.

Të dënuarit në këtë grupmoshë, veçanërisht me mbështetje familjare dhe qëndrueshmëri sociale, kanë tendencë të jenë më të respektueshëm ndaj detyrimeve ligjore dhe më pak të prirur ndaj sjelljeve devijante.

Mosha e avancuar përjashton praktikisht përfshirjen në cikle arsimimi apo punësimi që zakonisht ofrohen në IEVP. Megjithatë, në kushtet e lirisë me mbikëqyrje, individ mund të ruajë funksionimin bazë në shoqëri, sidomos në rol pasiv (si pjesëtar familjeje, qytetar me detyrime minimale, jo aktiv ekonomikisht), duke ndihmuar kështu në riintegrim të qetë dhe pa rrezikshmëri.

Gjendja e tij shëndetësore nuk e lejon që të angazhohet në mënyrë aktive në asnjë nga programet rehabilituese që ofron IEVP (arsimim, punësim, trajnim, terapi etj.).

Izolimi në këto kushte përkeqëson jo vetëm gjendjen fizike por edhe shëndetin mendor, duke e penguar rehabilitimin emocional dhe social.

Mungesa e trajtimit adekuat krijon ndjesi ankthi, humbje të shpresës dhe izolim të thellë, çka është kundër produktive për çdo proces rehabilitimi.

Nëse lirohet me kusht, i dënuari do të ketë mundësi të trajtohet në mënyrë të specializuar, të qëndrojë nën mbikëqyrje mjekësore dhe të jetë nën kontrollin e Shërbimit të Provës, gjë që redukton ndjeshëm çdo rrezik për komunitetin, lejon përshtatje të kontrolluar dhe graduale me jetën jashtë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

burgut, si dhe siguron kushte më njerëzore dhe më efektive për mbijetesë, sesa vuajtja e dënimit në kushte që i rrezikojnë jetën.

Sa më sipër, gjykata vlerëson se, mosha e avancuar dhe gjendja e rëndë shëndetësore ndikojnë drejtpërdrejt në pamundësinë për të kryer rehabilitim të vlefshëm brenda burgut. Ato zhvendosin nevojën për rehabilitim nga ambienti penal në atë shoqëror, me trajtim mjekësor të përshtatshëm dhe mbikëqyrje të jashtme.

Në këtë kontekst, riintegrimi është me i përshtatshëm jashtë IEVP-së, me ndihmën e sistemit të shërbimit të provës, familjes dhe kujdesit shëndetësor të specializuar. Lirimi me kusht është forma më epërshtatshme dhe efektive për rehabilitim për një të dënuar me moshë të avancuar dhe sëmundje të rënda, që nuk përbën rrezik për shoqërinë dhe që kërkon trajtim të vazhdueshëm dhe njerëzor.

ç. Dinamikene sjelljes së të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit në IEVP. Sjellja e të dënuarit një element kyç në lidhje me provën e riedukimit të tij. I dënuari, jovetëm që është i detyruar për të zbatuar me korrektësinë maksimale rregulloren brendshme të IEVP-së, por edhe të tregojë konkretisht, se gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit, sjellja e tij ka qenë e tillë sa për të çuar drejtpërfundimit se i dënuari vërtet ka treguar pendim, duke u sjellë me korrektesë bashkëvuajtës; autoritetet e IEVP-së; ka mbajtur (ose tentuar të mbajë) marrëdhënie të rregullta me familjarët e tij; ka normalizuar (ose tentuar të inormalizojë) marrëdhëniet me personin e dëmtuar/viktimën dhe familjen e tij, sidhe ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale; si dhe ka marrë pjesë në aktivitete pune, trajnuese, kulturore dhe edukative.

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjykata ka administruar dinamikën e sjelljes të të dënuarit ***** me nr.3499 prot., datë 14.07.2025, nga kurezulton se sjellja e tij është shumë e mirë. Gjatë zhvillimit të gjykimit, përfaqësuesi i IEVP Durrës ka relatuar para gjykatës që sjellja e të dënuarit është shëmbullore.

Nga dinamika e sjelljes së të dënuarit ***** rezulton se, gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit, si pasojë e izolimit të zgjatur, procesit të gjatë gjyqësor dhe problemeve të theksuara shëndetësore, i dënuari është diagnostikuar me “Çrregullim ankthi situacional”, duke shfaqur herë pas here gjendje të shqetësuar psiko-emocionale. Në vijim, ai është ndjekur nga staf i psiko-social, të cilët i kanë ofruar mbështetje psiko-emocionale përmes këshillimeve individuale, ndërsa paralelisht është trajtuar edhe me medikamente përkatëse, sipas rekomandimeve të mjekut. Aktualisht, gjendja e tij psiko-emocionale paraqitet e qëndrueshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

I dënuari është trajtuar me medikamentepërkatëse lidhur me gjendjen e ankthit, të cilat, sipas sektorit shëndetësor, ijanë administruar rregullisht.

I dënuari vuan nga disa probleme serioze tëshëndetit fizik, konkretisht: Sindroma Apne e Gjumit (SAK), HipertensionArterial në stadin III të pastabilizuar, Kardiopati Hipertensive, Dislipidemidhe rupturë e meniskut të gjurit të majtë (Genu sinister). Si pasojë e këtyreproblematikave, prej datës 05.06.2024 e në vijim, ai rezultoi i shtruar nëSpitalin Privat “Vila Maria”, referuar vlerësimit të sjelljes për transferim tëhartuar nga IEVP Fier, me nr. 2249 prot., datë 16.12.2024.

Referuar dokumentacionit të administruar nëdosjen psiko-sociale dhe kontakteve të marra me të dënuarin, rezultoi se ai nuk pranon kryerjen e veprës penale për të cilën është dënuar, dhe nuk mbështetmendime me natyrë kriminale.

Gjatë gjithë periudhës së vuajtjes sëdënimit, përfshirë dy vitet e fundit, i dënuari nuk ka shfaqur sjellje apoqëndrime që paraqesin rrezikshmëri ndaj bashkëvuajtësve apo stafit tëinstitucionit. Ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunuese dhe sociale me ta gjatëaktiviteteve të përbashkëta dhe ka respektuar me përpikmëri rregulloren einstitucionit dhe atë të Përgjithshme të Burgjeve.

Gjatë periudhës11.07.2023 deri më 11.07.2025, referuar dokumentacionit të administruar në dosjenpsiko-sociale, i dënuari ka ruajtur sjellje dhe qëndrim korrekt, nuk ështëndëshkuar me masa disiplinore, dhe nuk ka marrë pjesë në veprime që çenojnësigurinë apo qetësinë e institucionit.

Që prej transferimit nëIEVP Durrës, më datë 12.12.2024, i dënuari nuk është akomoduar fizikisht nëinstitucion pasi ka qenë i shtruar në Spitalin Privat “Vila Maria”, për shkaktë problemeve shëndetësore të avancuara, që nga data 05.06.2024. Sjellja e tij në ambientet spitalore, sipas të dhënave të sektorit të sigurisë, ka qenëkorrekte dhe në përputhje me rregulloren.

Ka respektuar detyrimetqë i takojnë brenda IEVP-së, si dhe rregulloren e institucionit. Nukjanë evidentuar raste të mbajtjes apo shpërndarjes së sendeve të ndaluara,përfshirë edhe objekte që mund të përbëjnë vepër penale. Nuk ka pasur tentativa nga ana e familjarëve për futjen esendeve të tilla në institucion.

I dënuari nuk ështëndëshkuar me masë disiplinore, nuk është përfshirë në veprimtari që bien ndeshme rregulloret e burgjeve dhe nuk është përfshirë në ndonjë rebelimininstitucional. Gjithashtu, nuk është konstatuar ndonjë tentativë për largim ngavendqëndrimi i detyrueshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Ka ndërtuar marrëdhëniekorrekte dhe bashkëpunuese me personelin civil dhe atë me uniformë, dukerespektuar etikën e komunikimit dhe rregulloren institucionale.

I dënuari ka ruajtursjellje korrekte dhe tolerante me të dënuarit e tjerë, nuk ka kryer veprime qëcënojnë liritë apo të drejtat e tyre, si dhunë fizike, psikologjike, manipulimapo bullizëm. Gjithashtu, nuk ka shfaqur sjellje simuluese për përfitimepersonale apo për manipulim të bashkëvuajtësve.

Gjatë vuajtjes sëdënimit, i dënuari ka marrë pjesë në mënyrë aktive dhe bashkëpunuese nëprogramet rehabilituese, përfshirë programin “Prezantimi i të Menduarit”, ku karefektuar mendime dhe sjellje pozitive. Po ashtu ka marrë pjesë në seancakëshillimi individual dhe në grup, analiza librash dhe veprimtari me rastin editëve ndërkombëtare.

Referuar dokumentacionit në dosjenpsiko-sociale, për periudhën 04.04.2022 - 19.12.2023, i dënuari ka shfaqurinteres dhe vullnet për përfshirje në punë, duke ushtruar funksionin e“lulishtarit” në institucion. Aktivizimi i tij në këtë detyrë ka qenë edhe nëfunksion të përballimit të gjendjes emocionale të rënduar gjatë procesit gjyqësordhe privimit nga liria.

I dënuari nuk ka qenë pjesë e programevearsimore të zhvilluara në institucion, për shkak se ka përfunduar arsimin elartë dhe zotëron një karrierë të konsoliduar profesionale në jetën e lirë,duke ushtruar funksione drejtuese në nivele të larta vendimmarrjeje. Referuadokumentacionit të administruar në dosjen psiko-sociale, i dënuari ka njëformim të pasur social, kulturor dhe profesional, ndaj nuk ka pasur nevojë përpërfshirje në programet e formimit profesional të ofruara nga institucioni, tëcilat targetojnë kryesisht kategori të tjera të të dënuarve me nevoja specifikearsimore dhe profesionale.

I dënuari është përfshirë në mënyrë aktive në veprimtaritë social-kulturore, si trajtime tematike në grup, analiza librashdhe aktivitete me karakter ndërveprues. Ka ndarë eksperiencat e tij mebashkëvuajtësit dhe stafin. Ka marrë pjesë në aktivitete sportive në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore, e cila është e komprometuar për shkak tëproblemeve të mëparshme fizike. Gjatë zhvillimit të programeve dhe veprimtarivetë përbashkëta, i dënuari ka shfaqur interes për temat e trajtuara, dukedëshmuar ndjenjë përgjegjësie dhe sjellje pozitive. Ka treguar bashkëpunim mestafin dhe të dënuarit e tjerë dhe ka reflektuar në mënyrë të dukshme nëqëndrimin e tij.

I dënuari është treguar bashkëpunues mestafin për arritjen e objektivave të trajtimit rehabilitues, në përputhje merregulloret përkatëse. Sjellja e tij ka qenë konsistente dhe korrekte përgjatëgjithë periudhës së vuajtjes së dënimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Referuar dokumentacionit të administruar nëdosjen personale, rezulton se i dënuari ka një nivel të lartë arsimor dhe profesional, dhe vjen nga një familje me status të qëndrueshëm ekonomik dhe kulturor. Është i martuar dhe ka tre fëmijë të rritur. Ruajtja e marrëdhënieve të ngushta me bashkëshorten dhe fëmijët, të cilët i konsideron si burim kryesor të mbështetjes emocionale, është e dukshme. Gjithashtu, ka raporteshumë të mira me familjen e origjinës, në mënyrë të veçantë me nënën, motrat dhe vëllain.

Gjatë gjithë periudhës së vuajtjes së dënimit, i dënuari ka zhvilluar takime të rregullta me familjen, e cila mbështet nga ana emocionale dhe materiale në mënyrë të vazhdueshme. Referuar kontakteve dhe dokumentacionit, i dënuari shfaqet i vetëdijshëm për pasojat që dënimi i ka shkaktuar jetës sociale dhe ekonomike të familjes, ndonëse nuk e pranon veprën penale për të cilën është dënuar.

Përfundimisht, Komisioni i Vlerësimit të Sjelljes ka konkluduar se, për periudhën e fundit 2-vjeçare të vuajtjes së dënimit, i dënuari ka arritur qëllimin kryesor të dënimit (rehabilitimin) dhe konsiderohet gatshëm për t'iu nënshtruar një procesi riintegruar pas lirimit.

Duke ubazuar në dinamikën e sjelljes të të dënuarit *****, Gjykata vlerëson se, sjellja e tij ka qenë e qëndrueshme, pa incidente dhe mbështetur në bashkëpunim me institucionin. Ai ka ruajtur normat e bashkëjetesës, respektin për rregullat, dhe nuk ka shfaqur rrezikshmëri të mëtejshme shoqërore.

Mosha, gjendja shëndetësore dhe rrethanat e qëndrimit e përforcojnë nevojën dhe mundësinë reale të riintegrit në shoqërinë një formë më të butë dënimi.

Kjo sjellje e qëndrueshme, përmbush kriterin e rëndësishëm të rehabilitimit, duke e bërë kërkesën për lirim me kusht të justifikuar dhe të mbështetur në ligj dhe praktikën gjyqësore.

d. Raportin e Shërbimit të Provës Durrës. Përveç kontrollit nëse i dënuari është riedukuar apo jo, gjykata duhet të analizojë edhe mundësinë, nëse i dënuari do të riintegrohet me sukses në shoqëri dhe nuk do të rezultojë me përsëritje veprash penale. Për këtë analizë, ndonëse të drejtuar drejt së ardhmes, gjykata ndihmohet nga raporti i Shërbimit të Provës. Sipas nenit 31/6, pika 3 e ligji nr.8331, datë 21.4.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", "Gjykata i kërkon shërbimit të provës të paraqesë një raport për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimit".

Në zbatim të nenit 31/6, pika 3 e ligji nr.8331, datë 21.4.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", Gjykata administroi nga Zyra e Shërbimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

të Provës Durrës raportin për kushtetfamiljare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit *****, si dhe përplanet konkrete për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimit.

Meraportin e vlerësimit individual për të dënuarin *****, Zyra e Shërbimit të Provës Durrës ka konkuduar se: *“Referuar përmbatjes së dokumentave, intervistave të kryera me familjaret dhe me vete të dënuarin, gjendja e rënde shëndetësore, moshën e tij (61 vjeç), sjelljen korrekte në IEVP, faktin që nuk ka asnjë mase disiplinore gjatë periudhës 4 vjeçare së gëndrimit të tij në IEVP, si dhe deklaratën noteriale premtim punësimi, bazuar në piken 1/ç të nenit 18 dhe pikën 4, të nenit 19 të Ligjit Nr. 78/2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Proves”, për arsyet e parashtuara me lart, Shërbimi i Proves shprehet se, nëse Gjykata do ta vlerësojë pozitivisht kërkesën e të dënuarit ***** për lirim me kusht mbështetur në nenin 64 të Kodit Penal, në lidhje me vendimin Nr. 61, datë 05.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krim të Organizuar Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 43 datë 08.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krim të Organizuar Tiranë, Shërbimi i Provës në Funksion të detyrimeve të percaktuara në vendimin e gjykatës do të hartojë Planin Individual të Trajtimit dhe do të mbikëqyrë të dënuarin me qëllim për të mundësuar rehabilitimin dhe rintegrimin e tij në jetën shoqërore në kushtet aktuale, përveç mbështetjes së procesit të rehabilitimit dhe përshtatjes në komunitet, është me rëndësi të sigurohet që idënuari të respektojë një sërë detyrimesh ligjore që e ndihmojnë të shmangë rikthimin në sjellje devijuese dhe të ndërtojë një mënyrë jetese të qëndrueshme.”*

Referuar raportit të Shërbimit të Provës, rezulton se sjellja e rregullt dhe mungesa e masave disiplinore tregojnë se i dënuari ka reflektuar mbi veprimet e tij dhe ka pranuar përgjegjësinë penale. Përfshirja në programe rehabilitimi dhe edukim idëshmon një përpjekje konkrete për përmirësimin personal dhe përgatitjen për një jetë të ligjshme pas vuajtjes së dënimit. Këto janë tregues të rëndësishëm se procesi i rehabilitimit ka filluar të japë rezultat.

Një rrjet i qëndrueshëm mbështetës, si familja dhe bashkëshortja, është faktor kyç në parandalimin e izolimit social të të dënuarit ***** dhe rikthimit në kriminalitet. Prania e një mjedisi të shëndetshëm familjar dhe emocional ndihmon në rimëkëmbjen morale dhe ruajtjen e një stili jetese në përputhje me ligjin. Familja gjithashtu ndikon pozitivisht në mbajtjen e angazhimeve dhe në monitorimin e risocializimit.

Sigurimi i një vendi pune pas lirimit është element thelbësor për riintegrimin shoqëror. Puna ofron jo vetëm të ardhura të ligjshme, por edhe një ndjenjë identiteti, dinjiteti dhe qëllimi. Ajo shmang situatat e pasigurta ekonomike që mund të çojnë në rikthim në kriminalitet dhe ndihmon të dënuarin të ruajë qëndrueshmërinë psiko-sociale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Gjendja shëndetësore e dobët e të dënuarit është një faktor që ul ndjeshëm rrezikun për të kryer vepra të tjera penale. Ajo e bën të pamundur përfshirjen në veprimtari të paligjshme dhe thekson nevojën që përkujdesja për shëndetin të zhvillohet jashtë ambienteve të paraburgimit, ku kushtet janë të kufizuara. Lirimi me kusht në këtë rast favorizon trajtimin e duhur mjekësor dhe përfshirjen e tij në sistemin shëndetësor publik, gjë që kontribuon në mirëqenie dhe stabilitet personal.

Nga analiza e veprës penale, e profilin personal dhe e sjelljes së tij gjatë vuajtjes së dënimit, rezulton se i dënuari paraqet një rrezikshmëri të ulët për shoqërinë. Rreziku i përsëritjes së veprës penale është i reduktuar në mënyrë të konsiderueshme. Kjo tregon se lirimi me kusht nuk përbën një kërcënim për rendin juridik apo për sigurinë publike.

Sipas Shërbimit të Provës, të gjitha këto të dhëna janë tregues të një procesi të avancuar rehabilitimi dhe tregojnë mundësi reale për riintegrim të suksesshëm në shoqëri, pa rrezik përsëritje të veprës penale. Në këtë kontekst, masa e lirit me kusht jo vetëm që përmbush funksionin e dënimit (retributiv dhe preventiv), por është edhe në përputhje me parimin e humanizmit, proporcionalitetit dhe qëllimit të rehabilitimit.

Zyra e Shërbimit të Provës Durrës është shprehur se, referuar rrethanave shëndetësore dhe socio-ekonomike të të dënuarit, si dhe të pjesëtarëve të familjes së tij, mund të hartohet një Plan Individual Trajtimi, në funksion të një procesi të mundshëm rehabilitues nga Shërbimi i Provës.

Plani Individual i Trajtit, i cili i është bashkangjitur raportit të Shërbimit të Provës, është një mjet irëndësishëm për garantimin e kontrollit dhe mbështetjes institucionale pas lirit, duke përmbushur kërkesën për mbikëqyrje dhe ndjekje të të dënuarit jashtë institucionit.

dh. Kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit. Kushtet e vështira ekonomike apo gjendja e rëndshëndetësore e familjarëve të të dënuarit, ndërkohë që në rastet dhe rrethanat të caktuara mund të merren në konsideratë si element potencial për efekt të uljes së rrezikut të recidivizmit, ato nuk duhet kurrësi që të konsiderohen, në vetvete, si element në disfavor të pranimit të kërkesës për lirim me kusht.

Në rastin konkret, i dënuari ***** nuk paraqet rrethanat të vështira ekonomike apo probleme të theksuara familjare. Megjithatë, mungesa e këtyre vështirësive nuk mund të interpretohet si element në disfavor të pranimit të kërkesës për lirim me kusht.

Referuar dinamikës së sjelljes, të hartuar nga IEVP Durrës, rezulton se i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

dënuari ***** mban marrëdhënie shumë të mira me familjarët. Ai realizon takime të rregullta fizike me ta dhe i konsideron ata si një burim të rëndësishëm mbështetjeje, si në aspektin emocional, ashtu edhe në atë material. Këto vlerësime janë konfirmuar edhe nga Shërbimi i Provës, i cili ka theksuar se i dënuari gëzon mbështetjen e familjes dhe ruan marrëdhënie të mira, të cilat shihen si faktor pozitiv për riintegrimin e tij në shoqëri.

Marrëdhëniet e shëndosha familjare përbëjnë një mbështetje të qëndrueshme psikologjike dhe sociale, që ndikon drejtpërdrejt në uljen e rrezikut të recidivizmit. I dënuari që gëzon një strukturë mbështetëse jashtë institucionit, është në gjendje të përballojë më lehtë tranzicionin drejt jetës së lirë, duke minimizuar nevojën për përfshirje në sjellje devijante.

Mbështetja emocionale nga familjarët ndihmon në ruajtjen e ekuilibrit psiko-social, ndërsa ndihma materiale shërbësi garanci për jetesë të pavarur dhe ligjore pas lirit. Këto përbëjnë një komponent kyç të rehabilitimit të suksesshëm në komunitet.

Fakti që të dy institucionet, IEVP Durrës dhe Shërbimi i Provës, kanë vlerësuar pozitivisht marrëdhëniet familjare të të dënuarit, i jep këtij faktor vlerë të shtuar provuese, duke e bërë atë të besueshëm dhe të rëndësishëm në vendimmarrjen për lirin me kusht.

Sa më sipër, gjykata vlerëson se, mbështetja e qëndrueshme familjare, e konfirmuar si nga IEVP Durrës ashtu edhe nga Shërbimi i Provës, përbën një garanci reale për riintegrimin shoqëror të të dënuarit ***** . Kjo rrethanë duhet të konsiderohet si një element lehtësues dhe favorizues në vlerësimin e kërkesës për lirin me kusht, duke treguar se i dënuari ka mbështetjen e nevojshme jashtë institucionit për të vijuar një jetë në përputhje me ligjin dhe normat shoqërore.

Bazuar në shkresën Nr. 4493/1 Prot., datë 23.07.2025, të lëshuar nga Komisariati i Policisë Durrës, në përgjigje të kërkesës për informacion lidhur me reputacionin dhe sjelljen e shtetasit ***** dhe familjes së tij në komunitetin ku jetojnë, rezulton se, nga verifikimet ekzyera në terren dhe informacionet e mbledhura nga strukturat vendore të rendit, nuk janë evidentuar të dhëna që të implikojnë shtetasin ***** apo anëtarë të familjes së tij si persona konfliktuale, qoftë në marrëdhëniet familjare, qoftë në raport me komunitetin ku banojnë. Në shkresë, Shefi i Komisarariatit, Komisar Algert Gjonaj, ka pohuar se nuk rezultojnë ankesa, denoncime apo indicie për sjellje të pahijshme apo shqetësuese nga ana e të dënuarit apo familjes së tij, si dhe nuk janë identifikuar konflikte apo përfshirje në ngjarje problematike në lagjen përkatëse.

Ky informacion është një tregues pozitiv në vlerësimin e rrezikshmërisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

shoqërore të të dënuarit dhe mbështet qëndrimin se ai gëzon reputaciontë mirë në komunitet, faktor që përbën një nga elementët ndihmës në analizën për lirimin me kusht, sipas praktikës gjyqësore dhe dispozitave të K.Pr.Penale.

e. Planet konkrete të të dënuarit për të mundësuar riintegrimin e plotë në shoqëri pas lirit. Këto plane duhet t'jën sa më realiste, n'raport me mundësitë efektive t' të dënuarit, dhe duhet t' shërbejnë për t' b'r'sa m' t' lehtë tranzicionin q' i dënuari kalon n' periudhën menjëherë pas lirit. Konkretisht, planet për t' punuar apo sigurimi i një kontratë puneduhën konsideruar si një element mjaft i rëndësishëm që shkon në favor të kërkuesit. Ndërkohë që sigurimi apo jo i një kontrate pune nuk është në vetvetenjë kriter ndalues për pranimin e kërkesës, me rëndësi është qasja e të dënuarit për të kërkuar aktivisht punësimin, si mjet efektiv i riintegrit të tij në shoqëri.

Gjykatavlerëson se, planet e riintegrit të plotë të të dënuarit ***** në shoqëri pas lirit janë reale dhe të mundëshme për t'u realizuar.

Referuar raportit të shërbimit të provës dhe akteve të tjera të depozituara nga i dënuari *****, rezulton se ku i fundit ka përfunduar arsimin e lartë dhe ka një karrierë të gjatë në funksione të larta publike. Konkretisht, ai ka ushtruar detyrën të rëndësishme si: anëtar i Këshillit Bashkiak të Durrësit, Kryetar i Bashkisë Durrës, deputet në Kuvendin e Shqipërisë për tre legjislatura, si dhe Ministër i Mjedisit. Për kontributin e dhënë në shërbim të komunitetit, është dekoruar dy herë me titullin "Qytetar Nderi" i Qytetit të Durrësit.

Në jetën e lirë, i dënuari ka mbajtur pozicione të rëndësishme drejtuese në nivelet e larta vendimmarrëse, çka dëshmon për një formim të pasur profesional, shoqëror dhe kulturor. Ai zotëron kualifikime të ndryshme dhe, për shkak të eksperiencës së tij të mëparshme, ka deklaruar se nuk ka patur të nevojshme përfshirjen në programet e formimit profesional të ofruara nga IEVP Durrës.

I dënuari ka përfunduar arsimin e lartë dhe zotëron një nivel të lartë kualifikimi profesional e kulturor. Kjo tregon se ai posedon aftësi dhe njohuri të mjaftueshme për t'u përfshirë në mënyrë të strukturuar në jetën sociale dhe ekonomike, pa pasur nevojë për rikthim në sjellje kriminale. Ky nivel formimi e bën të mundur rehabilitimin më të lehtë dhe efektiv në liri, pa pasur nevojë për ndërhyrje intensive korektuese.

Kryerja e detyrave të rëndësishme publike, si Kryetar Bashkie, Ministër dhe deputet, si dhe dekorimi me titullin "Qytetar Nderi" i Durrësit, janë tregues të një personaliteti me lidhje të forta me komunitetin dhe me ndjenjë përgjegjësie qytetare. Këto rrethana përbëjnë garanci për një sjellje të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

përgjegjshme dhe të përmbajtur në të ardhmen, dukeulur rrezikun e përsëritjes së veprës penale.

Gjithashtu, i dënuari ka paraqitur një deklaratë noteriale, me anë të së cilës garanton punësimin e tij të menjëhershëm në rast të pranimit të kërkesës për lirim me kusht. Sipas kësaj deklarate, ***** do të punësohet në cilësinë e administratorit pranë shoqërisë "ËIND CO" sh.p.k., me NIPT K12015501N, e përfaqësuar nga administratorja znj. Brunilda ***** (bashkëshortja e të dënuarit). I dënuari është zotuar se, në rast të lirimit, do të nisë menjëherë detyrën dhe do të respektojë me përpikëri detyrat që i ngarkohen, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Paraqitja e një deklarate noteriale për punësim të menjëhershëm në cilësinë e administratorit të një subjekti tregtar konkret, përbën një tregues të fuqishëm të ristrukturimit të jetës së të dënuarit dhe të gatishmërisë për t'u përfshirë në aktivitete të ligjshme. Një perspektivë e qartë punësimi ndihmon ndjeshëm në shmangien e izolimit social dhe përfshirjen aktive në jetën ekonomike, elementë kyç për një riintegrim të qëndrueshëm.

Angazhimi i bashkëshortes së të dënuarit si garantuuese për punësimin e tij, është tregues i një mbështetjeje reale familjare dhe sociale, që ndikon drejtpërdrejt në rehabilitimin dhe rikthimin e të dënuarit në jetën normale. Kjo thekson rëndësinë e rrjetit të qëndrueshëm social dhe familjar si faktor për suksesin e lirimit me kusht.

Rrethanat e përshkruara për të dënuarin ***** ndikojnë drejtpërdrejt dhe pozitivisht në procesin e riintegrit dhe rehabilitimit të tij.

Të gjitha rrethanat e mësipërme tregojnë se i dënuari posedon të gjitha kapacitetet personale, profesionale dhe sociale për t'u riintegruar në shoqëri pa rrezik për përsëritje të veprës penale. Gjithashtu, ekziston një strukturë konkrete mbështetëse (familjare, profesionale dhe institucionale), që i garanton zhvillimin e një jete tërregullt në liri.

Në këtë mënyrë, këto rrethana përbëjnë bazë të fortë për të mbështetur kërkesën për lirim me kusht, në përputhje me kriteret ligjore dhe parimet e rehabilitimit dhe proporcionalitetit penal.

Vazhdimi i vuajtjes së dënimit nga i dënuari ***** , në kushtet kur ai ka dëshmuar përmirësim të qartë të sjelljes së tij, nuk i shërben më funksionit edukues dhe proporcionalitetit të dënimit. Vijimi i dënimit pa një qëllim real rehabilitues, përbën cenim të së drejtës për trajtim njerëzor dhe dinjitoz, në kuptim të nenit 3 të KEDNJ.

Përsa u arsyetu si më sipër, gjykatavlerëson se, kërkesa e të dënuarit ***** për lirim me kusht për pjesën mbetur të dënimit të pavuajtur është e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

bazuar në ligj dhe prova.

Referuar nenit 38 të Ligjit Nr. 79/2020 “*Përkërkutimin e vendimeve penale*”, kur gjykata vendos lirim me kusht të të dënuarit, urdhëron lirim me menjëhershëm të dënuarit dhe dërgimin e vendimitprokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, ku do të jetojë i dënuari paslirimit, dhe institucionit të ekzekutimit të vendimit penal.

Prokuroriadhe institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, në të cilin ndodhet idënuari, duhet të kryejnë verifikimet e nevojshme dhe, nëse rezulton se idënuari *** nuk mbahet i paraburgosur apo i dënuar për ndonjë vepërtjetër penale, të urdhërojnë lirim me kusht të menjëhershëm.**

Nëse i dënuari ndodhet aktualisht nëparaburgim për një procedim tjetër penal, ai nuk do të lirohet menjëherë, porvetëm pas përfundimit të masës së sigurimit personal ose, në rast se ështëdënuar edhe për veprën tjetër penale, pas përfundimit të plotë të vuajtjes sëdënimit përkatës. Vendimipër lirim me kusht mbetet në fuqi, por shtyhet në kohë deri në përfundimin earsyeve të tjera që justifikojnë privimin nga liria.

Prokuroria dhe institucionii ekzekutimit të vendimeve penale kundodhet i dënuari duhet të bëjnë verifikimet e nevojshme dhe të urdhërojnëlirim me menjëhershëm të të dënuarit ***** , vetëm nëse ky i fundit nukmbahet i paraburgosur për ndonjë vepër tjetër penale.

[1] Shiko vendime GJEDNJ-ës, çështja “Kafkaris v. CYPRUS (Application no. 21906/04), data evendimit 12.02.2008.

[2] ShikoVendimi Unifikues Nr.2, datë 25.05.2015,të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Larë të Bashkuara të Gjykatës sëLartë të RSH.

[3] ShikoVendimi Unifikues Nr.2, datë 25.05.2015,të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Larë të Bashkuara të Gjykatës sëLartë të RSH.

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

Gjykata, bazuar nënenet 112 të K.Pr.Penale dhe në nenin 64 të K.Penal,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Vendosi:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lirimin me kusht të të dënuarit ***** ngavuajtja e mëtejshme e dënimit penal me burgim të caktuar ndaj tij me vendimin nr.61, datë 05.10.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë përKorrupcionin dhe Krimin e Organizuar, ndryshuar me vendimin me nr.43, datë08.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupcionin dhe Krimin eOrganizuar, për pjesën e mbetur të dënimit të pa vuajtur.
3. Urdhërohet i dënuari ***** që për një periudhëkohe sa pjesa e mbetur e dënimit të pavuajtur të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimine Provs, duke ju nënshtruar programit rehabilitues të përcaktuar nga kjo zyrë,me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepër tjetër penale.
4. Urdhërohet liri i të dënuarit ***** nga IEVPDurrës, nëse nuk mbahet i paraburgosur ose burgosur për ndonjë vepër tjetërpenale.
5. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen tëdënuarit *****.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankimnë Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit tëvendimit të arsyetuar.

U shpall në Durrës, me datë 25.07.2025

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.